



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/61
Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 9 i Ligjit Nr. 07/L-001mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Preliminar Financiar për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/61
Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) për rindërtimin e Kalasë së Ulqinit, pas dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Mal të Zi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, Kategoria subvencione 21200 - programi 10600, dhe bartën në Crnogorska Komercijalna Banka AD Podgorica në xhirrollogarinë IBAN ME 2551000000002242195.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/61
Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej dyqind mijë euro (200,000.00 €) për sanimin e dëmëve nga vershimet në Komunën e Bujanocit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore Ministria e Financave, me kod 201, në nën programin "Thesari", të kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari i Kosovës që të realizojë transferin e mjeteve në llogarinë e përcaktuar të Komunës së Bujanocit, sipas pikës 1. dhe 2. të këtij vendimi si dhe shkresës konfirmuese Nr. 255, datë 28.01.2021 me detajet bankare të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Komuna e Bujanocit do të njoftojë Qeverinë e Republikës së Kosovës pas pranimit dhe përdorimit të mjeteve në bazë të qëllimit sipas kërkesës me Nr. 255 të datës 28.01.2021.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtar në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit në këtë përbërje:
 - 1.1. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MI-së, kryesues;
 - 1.2. Iber Alaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së, anëtar;
 - 1.3. Besim Kamberaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MZHR-së, anëtar;
 - 1.4. Kujtim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Shoqëri të Informacionit/MPB anëtar;
 - 1.5. Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së, anëtar.
2. Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtarë në Bordin e lartcekur do të zbatojë rregullat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1, 3.2, 4.1 dhe 4.2 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2 të nenit 9 të këtij Ligji.
2. Obligohen Ministrinë e ndikuara, Komuna dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/61
Datë: 03.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Vendimin Nr. 06/58, datë 14.01.2021, lidhur me paragrafin 1.7, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 03/33, datë 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet buxhetore në shumë prej dymbëdhjetë milion euro (12,000,000.00 €) për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në nën-programin Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, me kod 40100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi alokohen dhe shfrytëzohen sipas kriterëve përkatëse të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit nr. 06/58, të datës 14.01.2021, si dhe në zbatim të Vendimit 03/33, të datës 28.09.2020.
3. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 03/33, të datës 28.09.2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 03/33, të datës 28 shtator 2020, ashtu që riformulohet si në vijim: "Me qëllim të zbatimit të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) në sektorin e bujqësisë, konkretisht Masës 4A - dyfishimit i buxhetit për Programin për Pagesa Direkte vetëm për vitin 2020, të paraparë në paragrafin 1.4, nënparagrafin 1.4.1, dyfishohen vlerat e pagesave direkte (subvencioneve) për secilën kulturë/masë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, krahasuar me vlerat e vitit 2019, ndërsa për subvencionim të litrit për verë të prodhuar gjatë vitit 2020 dhe deklaruar zyrtarisht deri më datë 15.01.2021, dyfishimi nga 4 centë në 8 centë për litër, do të përfshihet në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2021.
2. Pjesa tjetër e Vendimit bazik mbetet e pandryshuar.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 06/58, të datës 14.01.2021

1. Ndryshohet dhe plotësohet nën-paragrafi 1.7. (MASA 7) i Vendimit të Qeverisë Nr. 06/58, të datës 14 janar 2021, ashtu që riformulohet si në vijim: "Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në nën-programin Departamenti i Politikave Bujqësore, do të ndahen mjete në shumë prej 12,000,000 € (dymbëdhjetë milionë euro) sipas kriterëve dhe procedurave të Programit për Pagesa Direkte për vitin 2020".
2. Pjesa tjetër e Vendimit bazik mbetet e pandryshuar.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5, paragrafi 1, dhe neni 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/37, i datës 24.10.2020, për emërimin e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Korporata Energjetike e Kosovës/KEK" Sh.A.
2. Ndryshohet paragrafi 3.2 i vendimit bazë, në vend të z. Petrit Ibraj emërohet z. Muhamet Lama, anëtar i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Korporata Energjetike e Kosovës/KEK" Sh.A. dhe shërben në cilësinë e anëtarit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve, deri në përzgjedhjen e Bordit me mandat të plotë.
3. Emërimi sipas pikës 2. të këtij Vendimi bëhet pas dorëheqjes së anëtarit të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
4. Ky Vendim është pjesë e përbërëse Vendimit të Qeverisë Nr. 01/37, i datës 24.10.2020
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- NP KEK Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/61

Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Klinika e Ortopedisë në SHSKUK që në koordinim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe me Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, të bëjë furnizimin dhe rregullimin e protezave dhe ofrimin e shërbimeve të tjera që ndërlidhen me çështjen e protezave për nevoja të invalidëve të luftës së UÇK-së.
2. Autorizohet Klinika e Ortopedisë në SHSKUK, që në pajtim me legjislacionin në fuqi, të zhvillojë procedurat përkatëse të furnizimit me materjal nga pika 1. e këtij vendimi, marrë parasysh kapacitetet e saj, dhe sipas nevojës, edhe për kontraktimin e shërbimeve jashtë kapaciteteve të tyre.
3. Të gjitha shpenzimet për realizimin e nevojave nga pika 1. dhe 2. e këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Detajet e bashkëpunimit dhe koordinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, do të përcaktohen me një Memorandum të Bashkëpunimit ndërmjet Klinikës së Ortopedisë në SHSKUK, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/61

Datë: 03.02.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme të pronarit privat e cila preket nga realizimi i projektit - Restaurimi dhe Konzervimi i Objektivit të "Shtabi i UÇK-së në Kosterc" Komuna Skenderaj, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cileve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgonë vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/61
Datë: 03.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e trembdhjetë (13) vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesuese;
 - 1.2. Përfaqësues, Ministria e Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar dhe
 - 1.5. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;

2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentit, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues, Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4. Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar dhe
 - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.

3. Për punën e Këshillit Organizativ për shënimin e trembdhjetë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës ndahen mjete financiare në vlerë prej shtatëdhjetë mijë euro (70.000 €).

4. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kodet:
 1. Kodi 80100 vlera 20,000 €; 2.Kodi 80500 vlera 15,000 €; 3.Kodi 81900 vlera 20,000 €; 4.kodi 82100 vlera 5,000 €; 5.Kodi 81800 vlera 10,000 €.

5. Obligohet Ministra e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë